



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A

PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: ‘Ndertim Montim Impiant i Trajtimet i Ujerave te Ndotura dhe sistemi KUZ, Dhermi.’

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 34 (tirdhjetë e kater) muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45247130-0 - Punime ndërtimi për ujësjellës

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,129,210,978 (një miliard e njëqind e njëzet e nëntë milion e dyqind e dhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) **lek pa tvsh.**

Vlera ne euro: 12,161,669.00 (dymbëdhjetë million e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) **Euro pa Tvsh**

Kursi zyrtar i këmbimit, datë 14.08.2026, 1 Euro këmbëhet me 92.85 lekë

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga **Buxheti i Shtetit.**

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjdhjes së fituesit ka përgjdhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomiksht më e favorshme, bazuar në kosto **X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐

pikët 50

Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐ ☐

pikët 20

Stafi / Organizimi i Kompanise □ □

pikët 15

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □ □

pikët 10

Periudha e garancisë së objektit □ □

pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar **(jo më shumë se 34 muaj)**. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{mink2a} \times P_{maxk2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink2a} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk2a} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

***Shënim:** Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të vecanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mesiperme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënes të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

***Shënim:** Për përmbushjen e kriterit të mesipërme operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë të nderveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbejnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshihen:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë. projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij:

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi

kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e nie çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5, Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këte kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin sukses të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimit realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimit serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të siellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentoj në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me pervoiën e duhur mund të sielle rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventiv të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të deshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organigramen e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që në veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përveç realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e

gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet ti kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Per të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të çdo operatori ekonomik ofertues.

Nenkriteret për operatorët ekonomike pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave i Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migësore me miedisin të ricikluara/ eficiente/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

Një rëndësi e vecantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit e cila tregon jetegjatësinë e objektit, faktin se sa me maksimale të jetë periudha që përfshin garancinë e veprës e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.

Argumentim i detajuar i peshës së pikëve për secilin kriter vlerësimi të ofertës ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Autoriteti Kontraktor, në përcaktimin e sistemit të pikëzimit për vlerësimin e ofertave, ka mbajtur në konsideratë natyrën, kompleksitetin teknik, volumnin e punimeve, rreziqet e zbatimit dhe rëndësinë e secilit element në realizimin me sukses të objektit të kontratës.

Sistemi i pikëzimit është ndërtuar mbi një balancë ndërmjet elementit ekonomik dhe elementeve teknike e cilësore, duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe dispozitat e nenit 87 të Ligjit nr. 162/2020 për përdorimin e ofertës ekonomike më të favorshme dhe kërkesat e nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar për argumentimin e kriterëve.

Pesha e secilit kriter është përcaktuar sipas ndikimit real që ai ka në realizimin teknik, ekonomik dhe funksional të objektit.

1. Kriteri “Çmimi” – 50 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit

Kriteri i çmimit është vlerësuar me 50 pikë, duke qenë kriteri me peshën më të lartë në procesin e vlerësimit, pasi Autoriteti Kontraktor synon respektimin e parimit të efektivitetit dhe ekonomisë në përdorimin e fondeve publike.

Pesha prej 50 pikësh është vendosur duke respektuar kërkesën që, në rastet kur përdoren më shumë se një kriterë vlerësimi, kriteri ekonomik duhet të ketë rëndësi të konsiderueshme dhe të mos mbizotërohet nga elementët subjektivë teknikë.

Megjithatë, për shkak të natyrës së objektit, çmimi nuk është vendosur si kriter i vetëm, pasi realizimi i punimeve kërkon jo vetëm një ofertë ekonomike konkurruese, por edhe: kapacitete teknike të mjaftueshme; staf të kualifikuar; pajisje dhe makineri specifike; organizim efikas të punimeve; garantim të cilësisë dhe funksionalitetit të objektit.

Në punimet komplekse infrastrukturore, një ofertë me çmimin më të ulët nuk garanton automatikisht ofertën më të mirë, pasi një çmim jo realist mund të ndikojë në cilësinë e punimeve, afatet dhe qëndrueshmërinë e objektit.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka ruajtur një peshë të barabartë midis komponentit ekonomik (50 pikë) dhe komponentit teknik (50 pikë).

2. Kriteri “Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit” – 20 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit: Ky kriter është vlerësuar me 20 pikë, pasi në një kontratë ndërtimore me volum të konsiderueshëm punimesh, respektimi i afateve dhe organizimi i proceseve teknologjike janë faktorë thelbësorë për suksesin e zbatimit.

Objekti kërkon realizimin e një sërë procesesh të ndërlidhura si: mobilizimi i kantierit; organizimi i burimeve njerëzore; angazhimi i makinerive; realizimi i punimeve sipas fazave teknologjike; testimi dhe kolaudimi i sistemeve.

Një grafik pune i hartuar në mënyrë profesionale garanton: përdorim racional të makinerive; koordinim të ekipeve; shmangie të vonesave; kontroll të progresit të punimeve.

Pesha prej 20 pikësh është proporcionale me rëndësinë e këtij elementi, pasi vonesat në realizimin e punimeve infrastrukturore mund të sjellin pasoja teknike, ekonomike dhe sociale.

Ndarja e pikëve:

a) Koha e realizimit dhe mobilizimi – 15 pikë

Kjo pjesë vlerëson aftësinë e operatorit për të organizuar fillimin dhe realizimin e kontratës.

Koha e mobilizimit – 2 pikë

Është vlerësuar pasi mobilizimi i shpejtë ndikon në fillimin efektiv të punimeve, ngritjen e kantierit, sjelljen e makinerive dhe organizimin e stafit.

Grafiku i punimeve – 13 pikë

Është elementi kryesor i këtij kriteri, pasi tregon mënyrën konkrete se si operatori do të realizojë objektin brenda afatit kontraktor.

Kërkesa për analizën e makinerive dhe numrit të punonjësve për çdo proces është vendosur për të verifikuar që grafiku nuk është vetëm deklarativ, por teknikisht i realizueshëm.

b) Faktorë favorizues/pajisje inovative/metodologji – 5 pikë

Këto pikë synojnë të vlerësojnë operatorët që propozojnë metoda më efikase pune, përdorim teknologjish moderne dhe organizim që mund të reduktojë kohën e realizimit pa cenuar cilësinë.

3. Kriteri “Stafi / Organizimi i kompanisë” – 15 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit

Ky kriter është vlerësuar me 15 pikë, pasi realizimi i objektit kërkon jo vetëm fuqi punëtore, por staf teknik me eksperiencë dhe aftësi menaxhuese.

Punimet infrastrukturore kërkojnë koordinim ndërmjet disiplinave të ndryshme teknike, si:ndërtimi; hidroteknika; mekanika; elektriciteti; topografia; menaxhimi i cilësisë.

Për këtë arsye, eksperiencia dhe formimi profesional i stafit ndikojnë drejtpërdrejt në:cilësinë e zbatimit; kontrollin teknik; menaxhimin e riskut; respektimin e projektit.

Ndarja e pikëve:

a) Formimi akademik dhe eksperiencia – 13 pikë

Kjo pjesë ka peshën kryesore sepse aftësia profesionale e stafit është një nga faktorët kryesorë të suksesit të kontratës.

Përmbushja minimale e kërkesave – 1 pikë

Vlerëson garantimin e kapacitetit minimal të kërkuar.

Kualifikime akademike mbi minimumin – 3 pikë

Nxit angazhimin e personelit me përgatitje më të lartë profesionale.

Eksperiencë pune mbi minimumin – 3 pikë

Vlerëson përvojën praktike dhe aftësinë për menaxhimin e situatave teknike.

Eksperiencë në kontrata të ngjashme – 6 pikë

Ka peshën më të madhe pasi eksperiencia specifike në objekte të ngjashme ul ndjeshëm riskun e dështimit teknik.

b) Organizimi i stafit – 2 pikë

Vlerësohet mënyra e strukturimit të ekipit, komunikimi ndërmjet niveleve të menaxhimit dhe sistemet e kontrollit të cilësisë.

Një organizim i qartë siguron: përgjegjësi të përcaktuara; reagim të shpejtë ndaj problematikave; kontroll më të mirë të punimeve.

4. Kriteri “Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social” – 10 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit

Ky kriter është vlerësuar me 10 pikë, pasi punimet infrastrukturore kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedisin dhe komunitetin ku zhvillohen.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të rëndësishme jo vetëm realizimin fizik të objektit, por edhe mënyrën se si realizimi ndikon në: mjedisin; banorët; trafikun; përdorimin e burimeve natyrore.

Ndarja:

a) Masa mjedisore – 5 pikë

Vlerësohen: përdorimi i materialeve ekologjike; pajisjet me eficiencë më të lartë; reduktimi i pluhurit dhe ndotjes; menaxhimi i mbetjeve; masat parandaluese mjedisore.

b) Ndikimi social – 5 pikë

Vlerësohen: punësimi lokal; përfshirja e komunitetit; ndikimi pozitiv ekonomik në zonën e projektit.

5. Kriteri “Periudha e garancisë së objektit” – 5 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit

Ky kriter është vlerësuar me 5 pikë, pasi garantimi pas përfundimit të punimeve është një element i rëndësishëm për mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor.

Një periudhë më e gjatë garancie: tregon besueshmërinë e operatorit; garanton përgjegjësi për defektet; redukton kostot e mirëmbajtjes; siguron jetëgjatësi të objektit.

Ky kriter ka peshë më të ulët pasi garancia është një element pas përfundimit të punimeve dhe nuk ndikon në të njëjtën masë si çmimi, organizimi dhe kapacitetet teknike gjatë zbatimit.

Formula e vlerësimit relativ siguron trajtim proporcional dhe objektiv ndërmjet ofertave.

Përfundim i përgjithshëm

Ndarja e pikëve: 50 pikë për çmimin 50 pikë për komponentët teknikë, është një ndarje e balancuar dhe proporcionale me natyrën e objektit.

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se për një objekt kompleks ndërtimor, zgjedhja e operatorit ekonomik nuk mund të bazohet vetëm në ofertën më të ulët financiare, por duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë reale për realizimin e punimeve me cilësi, siguri dhe brenda afateve.

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatorit ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo



Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar Krite të veçanta të kualifikimit, Pika 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të Kriteve të veçanta të Kualifikimit;
- Licenca e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2 b), 2.3.2 c) , të kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 7 e DST-së.
- Staf i Teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3 c), 2.3.3/d , 2.3.3/g, 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të Kriteve të veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7 e DST-se.

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Autoriteti kontraktor ka vlerësuar se kapacitetet teknike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e punimeve kryesore nuk mund të transferohen tërësisht tek subjekte të treta, pasi kjo do të cenonte qëllimin e verifikimit të aftësisë reale të operatorit ekonomik që paraqet ofertën.

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është lejuar vetëm në masën që këto subjekte të marrin përsipër realisht realizimin e pjesës përkatëse të punimeve dhe të disponojnë licencat, personelin, pajisjet dhe eksperiencën që lidhet me zërat konkretë të preventivit që do të ekzekutojnë. Për këtë arsye është kërkuar që secili subjekt mbështetës ose anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë të disponojë licencat përkatëse në raport me punimet që merr përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve.

Ky kufizim mbështetet në faktin se:

- *Licencat e ndërtimit përbëjnë autorizime profesionale të lidhura me aftësinë konkrete të subjektit për të realizuar kategori të caktuara punimesh dhe nuk mund të përdoren*

formalisht nga një operator që nuk disponon kapacitetet minimale për ekzekutimin e kontratës.

- *Drejtuesit teknikë, stafi inxhinierik dhe specialistët e kërkuar janë të lidhur drejtpërdrejt me realizimin e punimeve të objektit dhe me mbikëqyrjen teknike të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit. - Pajisjet dhe materialet teknologjike të kërkuara në projekt kërkojnë njohuri të specializuara instalimi dhe përgjegjësi profesionale që nuk mund të garantohen nëse operatori ofertues nuk disponon vetë kapacitetet bazë teknike për realizimin e kontratës.*

Për rrjedhojë, kufizimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik ofertues të zotërojë vetë kapacitetet kryesore dhe thelbësore për realizimin e kontratës, ndërsa mbështetja nga subjektet e tjera të shërbejë vetëm si kapacitet plotësues dhe jo si zëvendësim i plotë i aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ofertues.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligiit N.162 / 2020 Per Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve, Vlorë Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentim për mosndarjen e objektit të prokurimit në lote

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se objekti i prokurimit nuk duhet të ndahet në lote, pasi ndarja e tij do të cenonte unitetin teknik dhe funksional të veprës, koordinimin e proceseve të zbatimit, përgjegjësinë për cilësinë e punimeve dhe garantimin e funksionimit të plotë të objektit të ndërtimit.

Ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, kompleksitetin teknik të ndërhyrjeve, ndërvlerësinë ndërmjet zërave të preventivit, kërkesat e projektit të zbatimit, mënyrën teknologjike të realizimit të punimeve dhe detyrimet ligjore që burojnë nga legjislacioni për prokurimin publik dhe ai për ndërtimin.

Objekti i prokurimit përbëhet nga një kompleks punimesh ndërtimore, hidroteknike dhe infrastrukturore, të cilat janë të lidhura ngushtë ndërmjet tyre dhe përbëjnë një proces të vetëm teknik për realizimin e një vepre funksionale.

Punimet e parashikuara nuk janë procese të pavarura, por janë pjesë të një cikli të integruar zbatimi, ku secila fazë varet nga realizimi korrekt i fazave paraardhëse dhe ndikon drejtpërdrejt në fazat pasardhëse.

Në mënyrë konkrete, punimet përfshijnë procese të tilla si: punime gërmimi dhe përgatitje të trasese; sistemim dhe përgatitje të bazamentit; furnizim dhe vendosje tubacionesh; montim rakorderish dhe elementesh lidhëse; realizim bashkimesh me saldim HDPE dhe elektrofuzion; ndërtim strukturash ndihmëse prej betoni; punime rikthimi dhe rehabilitimi të sipërfaqeve; testime me presion uji; inspektime teknike të rrjeteve; kolaudim dhe vënie në funksion të sistemit.

Këto procese përbëjnë një zinxhir teknologjik të pandashëm, ku cilësia e një procesi ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e gjithë veprës.

Për shembull, realizimi i tubacioneve nuk mund të konsiderohet i ndarë nga testimi i tyre me presion, nga kontrolli i bashkimeve, nga punimet e mbulimit dhe rikthimit të terrenit. Një ndarje e këtyre proceseve në lote të ndryshme do të krijonte vështirësi në përcaktimin e përgjegjësiive teknike në rast defektesh, rrjedhjesh ose mosfunksionimi të sistemit.

Zërat e preventivit janë hartuar mbi bazën e një procesi të vetëm ndërtimor dhe nuk përfaqësojnë punime të izoluar.

Punimet e gërmimit lidhen me vendosjen e tubacioneve; vendosja e tubacioneve lidhet me saldimin dhe bashkimin e elementeve; bashkimet lidhen me testimet e presionit; testimet lidhen me pranimin teknik të punimeve dhe më pas me rikthimin e terrenit.

Nëse këto punime do të ndaheshin në lote të ndryshme, do të krijoheshin problematika si: mungesë koordinimi ndërmjet operatorëve ekonomikë; vonesa në kalimin nga një fazë pune në tjetrën; ndërhyrje të ndërsjella në kantier; vështirësi në menaxhimin e grafikut të punimeve; vështirësi në përcaktimin e përgjegjësisë për dëmtime ose defekte; rritje e kostove administrative dhe teknike për administrimin e kontratave.

Për më tepër, një kontratë e vetme garanton që një subjekt i vetëm mban përgjegjësinë për integritetin teknik të të gjithë sistemit, duke shmangur ndarjen artificiale të përgjegjësiive ndërmjet disa kontraktorëve.

Realizimi i objektit kërkon disponimin e një grupi të integruar makinerish dhe pajisjesh specifike, të cilat përdoren në disa faza të ndryshme të punimeve.

Pajisjet si: makineritë për saldim HDPE; aparatet elektrofuzive; pajisjet e testimit me presion; automjeti për inspektim me kamera; pajisjet topografike; makineritë e gërmimit dhe transportit; nuk lidhen me një pjesë të izoluar të punimeve, por shërbejnë për realizimin e të gjithë procesit teknik.

Ndarja në lote do të sillte përsëritje të panevojshme të pajisjeve, shtim të kostove dhe ulje të eficiencës ekonomike të procedurës.

Në bazë të nenit 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen duke respektuar parimet e: transparencës; trajtimit të barabartë; mosdiskriminimit; eficiencës dhe ekonomisë në përdorimin e fondeve publike; proporcionalitetit.

Ndarja në lote nuk është një qëllim në vetvete, por një instrument që përdoret kur ajo sjell përfitime reale në drejtim të rritjes së konkurrencës dhe eficiencës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktor ka analizuar se ndarja në lote nuk do të sillte përfitim teknik apo ekonomik, por do të krijonte rrezik për: fragmentimin e përgjegjësisë teknike; uljen e kontrollit mbi cilësinë; vështirësi në koordinimin e punimeve; rritje të kostove të administrimit të kontratës.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, kërkesat dhe organizimi i procedurës duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës. Për një objekt kompleks ndërtimor, kërkohet që operatori ekonomik të ketë kapacitetet e plota teknike dhe profesionale për realizimin e të gjithë veprës.

Sipas nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht kriteret dhe kërkesat e

përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër, mosndarja në lote është vlerësuar si zgjidhja më e përshtatshme për natyrën konkrete të kontratës.

Sipas parimeve të legjislacionit shqiptar për ndërtimin dhe zbatimin e punimeve ndërtimore, realizimi i një vepre duhet të garantojë: përrputhshmërinë me projektin e zbatimit; cilësinë e materialeve dhe punimeve; qëndrueshmërinë dhe sigurinë teknike; kontrollin dhe kolaudimin e objektit.

Një objekt ndërtimi duhet të trajtohet si një tërësi funksionale, ku elementet përbërëse duhet të jenë të koordinuara dhe të ndërveprojnë sipas projektit teknik.

Ndarja në lote e proceseve që kanë lidhje teknologjike do të krijonte rrezik për humbjen e kontrollit të integruar të cilësisë dhe për mosfunksionimin e elementeve të veprës si një sistem i vetëm.

Duke marrë në konsideratë: natyrën komplekse të punimeve; ndërrarësinë e proceseve teknologjike; lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet zërave të preventivit; nevojën për një menaxhim unik të kantierit; kërkesën për një përgjegjësi të vetme teknike për cilësinë dhe funksionalitetin e objektit; parimet e eficiencës dhe proporcionalitetit sipas Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”;

Autoriteti Kontraktor ka arsyetuar se mosndarja e objektit të prokurimit në lote është zgjidhja më e përshtatshme teknike, ekonomike dhe ligjore, pasi garanton realizimin e plotë, të koordinuar dhe cilësor të objektit, duke shmangur fragmentimin e përgjegjësisë dhe duke siguruar mbrojtjen e interesit publik.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë sipas nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas balanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar **të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare**; ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Në keto kushte, vlerësojmë të kërkojmë kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi leshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi **të përshtatshëm** cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet

informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1 C** Punime gjurmimi në tokë
- **NP-2 D** Ndertime Civile dhe industriale
- **NP-4 B** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- **NP-5 A** Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- **NP-7 F** Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje;
- **NP-9 A** Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- **NP-11 B** Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- **N.P-12 A** Punime të inxhinierisë mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-6 A** Sinjalistika rrugore jo ndricuese
- **NS-8 A** Ndertime parafabrikat beton arme struktura metalike dhe druri
- **NS-14A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- **NS-18 C** Punime Topogjeodezike

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Kategoritë e licencës së kërkuar janë përcaktuar duke u bazuar në zërat konkretë të preventivit dhe në natyrën e punimeve që do të realizohen.

NP-1 C – Punime gërmimi në tokë

Kjo kategori kërkohet pasi preventivi përmban volume të konsiderueshme gërmimesh në tokë dhe shkëmb për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, stacioneve të pompimit dhe impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura. Në preventiv janë parashikuar gërmime me ekskavator, gërmime në kanale, gërmime shkëmbi me çekiç hidraulik, transport dheu dhe punime mbushjeje, të cilat përbëjnë një nga komponentët kryesorë të kontratës.

NP-2 D – Ndërtime civile dhe industriale

Kërkohet për realizimin e strukturave civile dhe industriale të impiantit, duke përfshirë betonime, betonarme, mure, hidroizolime, ndërtesa teknologjike, stacione pompimi, dhoma teknike dhe objekte ndihmëse. Preventivi përmban sasi të konsiderueshme betoni C20/25, C25/30 dhe C30/37, armatura çeliku, kallëpe, muratura dhe punime ndërtimore të impiantit.

NP-4 B – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

Kjo kategori lidhet me rikonstruksionin dhe rehabilitimin e sipërfaqeve rrugore pas vendosjes së rrjetit KUZ, përfshirë prerjen e asfaltit, skarifikimin, shtresat e çakëllit, binderin dhe asfaltobetonin. Preventivi përmban zëra për shtresa rrugore dhe asfaltime në sipërfaqe të konsiderueshme.

NP-5 A – Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti

Kërkohet për ndërtimin e pusetave, strukturave të betonit të armuar, galerive teknike, stacioneve të pompimit dhe veprave të tjera të kanalizimeve që klasifikohen si vepra arti dhe struktura nëntokësore.

NP-7 F – Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi dhe vaditje

Kjo është një nga kategoritë kryesore të kontratës pasi objekti përfshin ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, kolektorëve kryesorë, tubacioneve HDPE me diametra të ndryshëm, stacioneve të pompimit dhe shkarkimit final. Në preventiv janë parashikuar mijëra metra linearë tubacionesh HDPE dhe PE si dhe pusetat përkatëse.

NP-9 A – Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

Kategoria kërkohet për shkak të ndërtimit të sistemeve hidraulike të impiantit të trajtimit, linjave të shkarkimit, strukturave të kontrollit të ujërave dhe veprave të kullimit të lidhura me funksionimin e sistemit KUZ dhe ITUN.

NP-11 B – Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linjat TN/TM dhe shpërndarjen e energjisë

Preventivi përfshin instalime elektrike, panele kontrolli, furnizim me energji të stacioneve të pompimit, panele SCADA, sisteme automatizimi dhe pajisje elektromekanike. Për këtë arsye kërkohet licenca për realizimin e infrastrukturës energjetike dhe elektrike të objektit.

NP-12 A – Punime të inxhinierisë mjedisore

Objekti i kontratës është ndërtimi i një Impianti të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), i cili përbën vepër tipike të inxhinierisë mjedisore. Të gjitha proceset e trajtimit biologjik, menaxhimit të llumit dhe shkarkimit të ujërave të trajtuara lidhen drejtpërdrejt me këtë kategori.

NS-1 A – Punime për prishjen e ndërtimeve

Kjo kategori justifikohet nga zërat e prerjes së asfaltit, skarifikimit të shtresave ekzistuese dhe ndërhyrjeve në infrastrukturën ekzistuese për hapjen e traseve të rrjetit KUZ dhe rikthimin e tyre në gjendjen fillestare.

NS-6 A – Sinjalistika rrugore jo ndriçuese

Kategoria lidhet me menaxhimin e trafikut dhe rikthimin në gjendje funksionale të segmenteve rrugore ku kalon rrjeti KUZ, si dhe me elementët e sinjalistikës së nevojshme gjatë dhe pas zbatimit të punimeve.

NS-8 A – Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

Në preventiv janë parashikuar trarë çeliku për vinçat, platforma inox, zgara metalike, shkallë inox, parmakë inox dhe elementë të tjerë strukturorë metalikë të nevojshëm për impiantin dhe stacionet e pompimit.

NS-14 A – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni dhe TV

Kjo kategori kërkohet për realizimin e instalimeve elektrike të impiantit, paneleve të kontrollit, sistemeve SCADA, kabllimeve, automatizimit dhe komunikimit të sistemeve teknologjike të ITUN dhe stacioneve të pompimit.

NS-18 C – Punime topogjeodezike

Punimet e rrjetit KUZ shtrihen në një territor të gjerë dhe përfshijnë gjurmimin e traseve, piketimin, kontrollin altimetrik e planimetrik të tubacioneve, kontrollin e kuotave të pusëve dhe hartimin e dokumentacionit “as built”. Për këtë arsye kërkohet licenca për punime topogjeodezike gjatë gjithë fazës së zbatimit.

Përfundimisht, të gjitha kategoritë NP dhe NS të kërkuara janë në raport të drejtpërdrejtë me zërat e preventivit, natyrën teknike të objektit dhe kompleksitetin e punimeve që përfshijnë rrjetin e kanalizimeve, stacionet e pompimit, impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, sistemet elektrike, mekanike dhe SCADA.

b) Certifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit të cilesise** vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 (per sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- Certifikatë **SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021**, (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim), e vlefshme, ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj (përveçse gjuhës angleze), ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”¹ në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet

ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Çertifikatë ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Çertifikatë ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit” kerkohet pasi angazhimi per mbrojtjen e mjedisit eshte nje kriter madhor ne zgjedhjen e nje prodhuesi, kurse metoda me efikase per te shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin eshte zbatimi i nje sistem menaxhimi per mjedisin konform me parashikimet e standartit nderkombetar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 bëhet pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates. Të gjitha punimet e parashikuara në vepër duhen kryer në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në pune”, ose certifikatë me standartin e përditësuar **Certifikatë ISO 45001-2023** mundëson që çdo

shoqëri të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj. Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Çertifikatë ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbytje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kërkesa për disponimin e Certifikatës SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021 ose ekuivalente është në përpjesëtim të drejtë me objektin e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë punime të shumta saldimi dhe montimi të strukturave metalike.

Kjo certifikatë kërkohej pasi në preventiv janë parashikuar elementë konstruktivë metalikë dhe inox të cilët realizohen nëpërmjet proceseve të saldimit, ndër të cilët: Ndërtimi i trarëve të çelikut për vincat (An.177); Traret e vincit (An.178); Furnizimi dhe instalimi i platformave me grilë prej çeliku inox SST 316 (An.179); Furnizimi dhe instalimi i parrakeve prej inoksi SST 316 (An.182); Furnizimi dhe instalimi i shkallëve prej çeliku inox SST 316 (An.184); Furnizimi dhe instalimi i zgarrave të platformave prej materiali inox SST 316 (An.188); Lyerja dhe mbrojtja e konstruksioneve të çelikut me sisteme epokside (An.187); Porta kryesore metalike e hyrjes së ITUN (An.191); Tubacionet inox me fllanxha, bërnylat inox, tee inox, mbështetëset metalike dhe elementët ndihmës të stacioneve të pompimit. Realizimi i këtyre punimeve kërkon procese saldimi të kontrolluara, pasi defektet në saldim mund të shkaktojnë: humbje të rezistencës mekanike të strukturave mbajtëse; korrozion të parakohshëm në mjedise me lagështi dhe ujëra të ndotura; deformime të elementëve metalikë; probleme funksionale në stacionet e pompimit dhe impiantin e trajtimit; rritje të kostove të mirëmbajtjes dhe rrezik për sigurinë e objektit.

ISO 3834-2:2021 përcakton kërkesa të plota për kontrollin e cilësisë së proceseve të saldimit, duke përfshirë personelin e saldimit, procedurat e saldimit, materialet, pajisjet, inspektimet, testimet dhe dokumentimin e cilësisë. Standardi zbatohet për saldimitin e materialeve metalike si në punishte ashtu edhe në kantier.

Duke qenë se objekti përfshin ndërtimin e strukturave çeliku, elementëve inox SST 316, platformave metalike, shkallëve, parrakeve, trarëve të vincit dhe elementëve të tjerë të salduar që janë pjesë integrale e funksionimit të ITUN dhe stacioneve të pompimit, disponimi i certifikatës ISO 3834-2:2021 garanton që operatori ekonomik zotëron një sistem të kontrolluar të menaxhimit të cilësisë në saldim dhe është i aftë të realizojë punime saldimi sipas standardeve ndërkombëtare të kërkuara për këtë kontratë.

Për rrjedhojë, kërkesa për Certifikatën ISO 3834-2:2021 ose ekuivalente është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit, natyrën e punimeve metalike të parashikuara dhe nevojën për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe jetëgjatësisë së veprës.

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ Tuba te brinjezuar SN8
- ✓ Pompe zhytese grirese
- ✓ Pompe shtytese
- ✓ Mates uji
- ✓ Gjenerator 500 KVA
- ✓ Sistem Scada

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj (pervecese gjuhes angleze), ky dokument mund të paraqitet në gjuhën zyrtare shqipe ose angleze.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektivit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.

- Operatori Ekonomik të paraqese certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit, autorizimit të distributorit të autorizuar nga prodhuesi ose marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe katalogëve teknikë për materialet dhe pajisjet kryesore të sistemit të furnizimit me ujë.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të

mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar minimalisht **80 (tetedhjetë)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se **80 (tëtdhjetë)** punonjësish për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

Bazuar në preventivin e punimeve të projektit “**Implant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ, Dhërmi**”, kërkesa për disponimin e **minimalisht 80 (tëtdhjetë) punonjësve për periudhën e 3 muajve të fundit** është e justifikuar nga volumi shumë i madh i punimeve, fondi limit, afatet e realizimit dhe natyra multidisiplinare e objektit. Preventivi përfshin volume të konsiderueshme gërmimesh, betonimesh, armaturash, punime rrugore, punime hidraulike, elektrike, mekanike dhe montime metalike, të cilat duhet të realizohen paralelisht në disa fronte pune

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e minimalisht 80 (tëtdhjetë) punonjësve për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit para datës së hapjes së procedurës së prokurimit.

Ky kriter është vendosur duke marrë në konsideratë volumin e punimeve të parashikuara në preventiv, vlerën e konsiderueshme të kontratës, kompleksitetin teknik të objektit dhe nevojën për zhvillimin e punimeve në disa fronte pune njëkohësisht.

Preventivi i punimeve përfshin: Mbi 78,000 m³ gërmime dhe transport masiv dheu e shkëmbi; Mbi 2,500 m³ struktura betoni dhe betonarmeje; Mbi 300 ton hekur betoni; Punime të shumta mbushjeje, shtresash rrugore dhe asfaltimi; Ndërtimin e veprave të kanalizimeve dhe strukturave të implantit; Punime elektrike, mekanike dhe hidraulike; Montime të elementëve metalikë dhe inox; Punime të stacioneve të pompimit dhe objekteve teknologjike të implantit.

Për realizimin e këtyre volumeve është e domosdoshme angazhimi paralel i: ekipeve të gërmimit dhe transportit; ekipeve të betonimit dhe armimit; ekipeve të montimit të tubacioneve; ekipeve të punimeve elektrike dhe mekanike; ekipeve të strukturave metalike dhe saldimit; ekipeve të punimeve rrugore dhe asfaltimit; ekipeve të topografisë dhe kontrollit teknik; personelit mbështetës të kantierit.

Nga analizimi i volumeve të preventivit rezulton se realizimi i punimeve brenda afateve kontraktuale kërkon funksionimin paralel të disa grupeve pune, ku secili grup përbëhet nga specialistë, operatorë makinerish dhe punëtorë të kualifikuar. Për këtë arsye, disponimi i të paktën 80 punonjësve përbën një tregues të kapacitetit organizativ dhe teknik të operatorit ekonomik për të përballuar një objekt me përmasa të mëdha dhe me karakter kompleks.

Kërkesa nuk synon kufizimin e konkurrencës, por verifikimin e aftësisë reale të operatorit ekonomik për të mobilizuar burimet njerëzore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës sipas grafikut të punimeve, standardeve teknike dhe kërkesave të sigurisë në kantier.

Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e minimalisht 80 punonjësve është në raport të drejtë me natyrën, vlerën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe konsiderohet e nevojshme për garantimin e realizimit me sukses të objektit të prokurimit.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Ndertimi Profili Gjeoteknik 1 (një)
- Inxhinier Ndertimi profili Strukturist 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (nje)
- Inxhinier Materialesh 1 (nje)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

1. Kontratë pune të vlefshme,
2. Diplome,
3. Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, ku duhet të figurojnë stafi i mësipërm

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklaratimet e operatorit ekonomik në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Shenim : Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për inxhinieret e mesipërm, emer/mbiemer, atesia, numrin personal te ID , numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë),

si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi profili Infrastruktura Transporti 1(një)
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe te figuroje ne Listepagesa per te pakten 3 muajt e Fundit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

❖ *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 (tre) muajt e fundit sipas kodit përkatës të profesionit bazuar në VKM Nr. 514, datë 20.9.2017, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------------|-----------|
| - Teknik Ndërtimi | 3 (tre) |
| - Teknik Topagraf | 3 (tre) |
| - Teknik Mekanik | 2 (dy) |
| - Teknik Elektrik | 1 (nje) |
| - Hidraulik | 5 (pese) |
| - Muratore | 3 (tre) |
| - Betonues | 4 (kater) |
| - Karpentier | 5 (pese) |
| - Hekurkthyes | 4 (kater) |
| - Elektracist | 3 (tre) |
| - Specialist konstruksione metalike | 3 (tre) |
| - Saldator | 4 (kater) |
| - Specialiste punime asfalti | 3 (tre) |

- Hidroizolues 2 (dy)
- Specialist montim tubash 2 (dy)

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm (*me përjashtim të punonjësve shoferë*) të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Per specialistet saldatore pervecse dokumentacionit te siperkerkuar, duhet te jene te pajisur me certificate, 2 (dy) prej tyre duhet te disponojne certifikimin per punime speciale te saldimit sipas standartit **SSH EN ISO 9606-1:2017**, dhe 2 (dy) cerifikimin per punime speciale te saldimit te tubave plastike sipas standartit **SSH EN ISO 13067:2020** të cilat mbulojnë proceset e saldimit dhe dimensionet Saldim me elektrofuzion, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumnte duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- **7 (shtate)** Eskavatoristë
- **5 (pese)** Automakinistë
- **3 (tre)** Buldozeristë
- **5 (pese)** Shofere

të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela

personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; **dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Gjithashtu, bazuar në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore për licencimin profesional në fushën e ndërtimit, zbatimi i punimeve të ndërtimit duhet të realizohet nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e personelit teknik të kualifikuar sipas profileve përkatëse të inxhinierisë.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, kërkesa për disponimin e stafit inxhinierik është vendosur në funksion të realizimit të objektit “Impianti i Trajtimin të Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ, Dhërmi”, duke u bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe volumet e konsiderueshme të punimeve të parashikuara në preventiv.

Objekti përfshin punime gjurmimi dhe mbushjeje, ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, stacioneve të pompimit, strukturave të betonarmeve, instalimeve mekanike dhe elektrike, sistemeve hidraulike, punimeve mjedisore, strukturave metalike dhe kontrollit topografik, të cilat kërkojnë mbikëqyrje profesionale nga specialistë të fushave përkatëse.

1. Inxhinier Hidroteknik – 1 (një)

Kërkohet për shkak se objekti lidhet drejtpërdrejt me ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura. Ky inxhinier është përgjegjës për kontrollin teknik të rrjeteve hidraulike, puseta, kolektorëve, stacioneve të pompimit, veprave të kullimit dhe funksionimit hidraulik të impiantit. Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me zërat e kanalizimeve, punimet hidraulike, pusetat, kanalet kulluese dhe strukturat e trajtimit të ujërave.

2. Inxhinier Gjeodet – 1 (një)

Kërkohet për realizimin e piketimit, kontrollit altimetrik dhe planimetrik të të gjitha punimeve. Duke qenë se projekti përfshin mijëra metra linearë rrjete kanalizimi, pusetash, rrugësh dhe strukturash betoni, kontrolli topografik është i domosdoshëm gjatë gjithë fazës së zbatimit. Kjo kërkesë lidhet me të gjithë zërat e gjurmimeve, rrjeteve nëntokësore dhe veprave civile.

3. Inxhinier Gjeoteknik – 1 (një)

Kërkohet për monitorimin e kushteve gjeologjike dhe gjeoteknike gjatë realizimit të gjurmimeve masive në tokë dhe shkëmb. Preventivi përfshin volume shumë të mëdha gjurmimesh në tokë dhe shkëmb, përfshirë gjurmime me ekskavator dhe me çekiq hidraulik, ku stabiliteti i skarpave dhe themeleve duhet të kontrollohet vazhdimisht.

4. Inxhinier Ndërtimi, Profili Infrastrukturë Transporti – 1 (një)

Kërkohet për shkak të punimeve të rikonstruksionit dhe rehabilitimit të sipërfaqeve rrugore pas vendosjes së rrjeteve, si dhe realizimit të shtresave rrugore, binderit, asfaltobetonit, bordurave, trotuareve dhe elementëve të tjerë të infrastrukturës rrugore. Kjo lidhet drejtpërdrejt me zërat e shtresave rrugore dhe asfaltimeve të parashikuara në preventiv.

5. Inxhinier Ndërtimi, Profili Strukturist – 1 (një)

Kërkohet për mbikëqyrjen e realizimit të strukturave të betonit dhe betonarmesë, mureve mbajtëse, rezervuarëve, stacioneve të pompimit dhe strukturave të impiantit. Preventivi përmban volume të konsiderueshme betoni, armature, kallëpesh dhe strukturash të betonarmeve që kërkojnë kontroll të vazhdueshëm strukturor.

6. Inxhinier Mekanik – 1 (një)

Kërkohet për instalimin dhe kontrollin e pajisjeve mekanike të impiantit dhe stacioneve të pompimit, duke përfshirë pompat, valvulat, pajisjet e trajtimit, elementët inox, shkallët metalike, parrakët, platformat dhe strukturat ndihmëse të parashikuara në preventiv.

7. Inxhinier Elektrik – 1 (një)

Kërkohet për mbikëqyrjen e instalimeve elektrike, furnizimit me energji, paneleve elektrike, kabinave, sistemeve të komandimit dhe shpërndarjes së energjisë për impiantin dhe stacionet e pompimit. Kjo lidhet me të gjithë komponentët elektrikë të objektit.

8. Inxhinier Elektronik – 1 (një)

Kërkohet për sistemet e automatizimit, kontrollit dhe monitorimit të proceseve teknologjike të impiantit, përfshirë pajisjet elektronike, instrumentacionin, sistemet e telekomandimit dhe integrimin e sistemeve SCADA që janë pjesë funksionale e impianteve moderne të trajtimit të ujërave të ndotura.

9. Inxhinier Materialesh – 1 (një)

Kërkohet për kontrollin e cilësisë së materialeve të përdorura gjatë zbatimit të kontratës, duke përfshirë betonin, hekurin e armimit, materialet e shtresave rrugore, asfaltin, materialet hidroizoluese dhe elementët metalikë. Duke qenë se preventivi përmban volume të konsiderueshme betoni, armature, çakëlli, stabilizanti dhe asfalti, kontrolli laboratorik dhe teknik i materialeve është i domosdoshëm për garantimin e cilësisë së veprës.

Përfundimisht, numri dhe profilet e mësipërme të inxhinierëve janë në raport të drejtë me natyrën e objektit, kompleksitetin teknik dhe volumet e konsiderueshme të punimeve të parashikuara në preventiv. Secili specialist mbulon një disiplinë të veçantë teknike të domosdoshme për realizimin e sigurt, cilësor dhe në përputhje me projektin të punimeve objekt kontrate.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë staf inxhinierik mbështetës, jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, për të garantuar realizimin cilësor dhe brenda afateve të punimeve objekt kontrate.

Kërkesa për disponimin 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik, 1 (nje) Inxhinier Ndertimi profili Infrastruktura Transporti 1(një), 1 (nje) Inxhinier Mjedisi është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të objektit, kompleksitetin teknik dhe volumet e konsiderueshme të punimeve të parashikuara në preventiv.

Inxhinier Hidroteknik – 1 (një)

Objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me ndërtimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), stacioneve të pompimit dhe sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura. Preventivi përfshin ndërtimin e strukturave hidraulike, pusetave, kanaleve kulluese, veprave të drenazhimit dhe elementëve të tjerë të sistemit hidroteknik. Gjithashtu janë parashikuar punime të shumta betoni, betonarmeje, hidroizolimi dhe struktura të lidhura me procesin e trajtimit të ujërave. Për këtë arsye është i domosdoshëm një Inxhinier Hidroteknik për të mbikëqyrur zbatimin e saktë të parametrave hidraulikë dhe funksionalë të projektit.

2. Inxhinier Gjeodet – 1 (një)

Preventivi përfshin volume shumë të mëdha gërmimesh në tokë dhe shkëmb, transport materialesh, mbushje, ndërtim të rrjeteve nëntokësore dhe strukturave të ndryshme të impiantit. Vetëm zërat e gërmimeve përfshijnë dhjetëra mijëra metra kub gërmime dhe transport materiali, çka kërkon piketim, kontroll altimetrik dhe planimetrik të vazhdueshëm gjatë gjithë procesit të zbatimit. Inxhinieri Gjeodet është i domosdoshëm për gjurmimin e akseve të rrjeteve, kontrollin e kuotave të projektit, verifikimin e volumeve të punimeve dhe përgatitjen e dokumentacionit topografik të objektit.

3. Inxhinier Ndërtimi profili Infrastruktura Transporti – 1 (një)

Preventivi përmban volume të konsiderueshme të punimeve civile dhe strukturore, duke përfshirë mbi 3,900 m³ beton C16/20, C20/25, C25/30 dhe C30/37, mbi 300 ton hekur betoni, mijëra metra katrorë kallëpe, muratura, hidroizolime, shtresa rrugore, asfaltime dhe struktura të ndryshme betonarmeje. Për shkak të vëllimit të konsiderueshëm të këtyre punimeve dhe nevojës për kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së zbatimit, është i domosdoshëm disponimi i një Inxhinieri Ndërtimi, i cili do të ndjekë organizimin e punimeve, kontrollin teknik të strukturave dhe zbatimin e projektit sipas specifikimeve teknike.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkesa për disponimin e stafit teknik të specializuar është përcaktuar në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe volumeve të konsiderueshme të punimeve të parashikuara në preventivin e objektit “Impianti i Trajtit të Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ, Dhërmi”.

Inxhinier Mjedisë – 1 (një)

Kërkohet duke qenë se objekti është një impiant trajtimi i ujërave të ndotura, i cili përbën një vepër tipike të inxhinierisë mjedisore. Ky specialist monitoron përputhshmërinë e punimeve me kërkesat mjedisore, menaxhimin e mbetjeve të gërmimeve, mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e kushteve të lejeve mjedisore.

Teknik Ndërtimi – 3 (tre)

Kërkohen për ndjekjen e përditshme të punimeve civile dhe strukturore në disa fronte pune njëkohësisht. Volumet e mëdha të betonit, armaturës, kallëpeve, muraturave, mbushjeve dhe veprave të betonarmesë kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme teknike në terren. Kërkohen për shkak të volumeve të konsiderueshme të punimeve civile dhe strukturore të parashikuara në preventiv, si: Beton C16/20, C20/25, C25/30 dhe C30/37; Armaturë çeliku B500B; Kallëpe për themele, mure, trarë dhe soleta; Mure betonarmeje të rezervuarëve dhe strukturave të impiantit; Ndërtimi i stacioneve të pompimit dhe objekteve teknologjike.

Për shkak të zhvillimit paralel të këtyre punimeve në disa fronte pune, kërkohen 3 teknikë ndërtimi për kontrollin e vazhdueshëm të zbatimit.

Teknik Topograf – 3 (tre)

Punimet përfshijnë gërmime masive, rrjete kanalizimi, puseta, kanale dhe struktura të shpërndara në një sipërfaqe të konsiderueshme. Për këtë arsye nevojiten disa ekupe topografike për piketimin, kontrollin e kuotave dhe matjet e vazhdueshme gjatë zbatimit.

Kërkohen për shkak të zërave: Gërmime në tokë; Gërmime në shkëmb; Hapje kanalesh për tubacionet KUZ; Ndërtim pusetash; Vendosje rrjetesh kanalizimi; Rikonstruktion i sipërfaqeve rrugore.

Objekti përfshin shtrirje lineare të konsiderueshme të rrjetit KUZ dhe realizimin e shumë strukturave në koordinata dhe kuota të ndryshme, duke e bërë të domosdoshme praninë e vazhdueshme të personelit topografik.

Teknik Mekanik – 2 (dy)

Kërkohen për montimin dhe kontrollin e pajisjeve mekanike të impiantit dhe stacioneve të pompimit, si dhe për elementët inox, shkallët metalike, platformat, parmakët dhe strukturat ndihmëse të parashikuara në preventiv.

Kërkohen për realizimin e zërave: Montim pompash; Montim valvulash dhe aksesorësh hidromekanikë; Montim pajisjesh teknologjike të impiantit; Montim platformash inox; Montim shkallësh metalike; Montim parmakësh inox; Montim elementësh mekanikë të stacioneve të pompimit.

Teknik Elektrik – 1 (një)

Kërkohet për koordinimin e punimeve elektrike që lidhen me funksionimin e impiantit, stacioneve të pompimit, kabinave elektrike dhe sistemeve të furnizimit me energji.

Kërkohet për zërat: Panele elektrike; Kabina elektrike; Linja furnizimi; Sisteme komandimi; Pajisje elektrike të stacioneve të pompimit; Pajisje elektrike të ITUN.

Hidraulik – 5 (pesë)

Numri i kërkuar justifikohet nga natyra kryesore e kontratës, e cila lidhet me ndërtimin e sistemit KUZ dhe impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura. Punimet përfshijnë montimin e tubacioneve, puseta, kolektorëve, nyjeve hidraulike dhe elementëve të tjerë të rrjetit. Për shkak të volumeve dhe nevojës për zhvillimin paralel të punimeve në disa segmente, kërkohen 5 hidraulikë.

Numri i hidraulikëve është bazuar nga zërat kryesorë të preventivit: Tubacione HDPE me diametra të ndryshëm; Puseta kontrolli; Kolektorë kanalizimesh; Rakorderi dhe nyje lidhëse; Tubacione presioni; Linja të shkarkimit; Pajisje hidraulike të impiantit.

Duke qenë se rrjeti KUZ përbën një nga komponentët kryesorë të kontratës dhe punimet zhvillohen në disa segmente njëkohësisht, nevojiten 5 hidraulikë.

Murator – 3 (tre)

Kërkohen për realizimin e muraturave, puseta, kanaleve, strukturave ndihmëse dhe punimeve të tjera civile të përfshira në objekt. Preventivi përmban volume të konsiderueshme murature dhe punimesh ndërtimore. Kërkohen për realizimin e: Puseta të betonit; Strukturave ndihmëse; Mureve të impiantit; Kanalet teknologjike; Veprat civile të stacioneve të pompimit.

Betonues – 4 (katër)

Kërkohen për realizimin e volumeve shumë të mëdha të betonit dhe betonarmesë, të cilat përfshijnë rezervuarë, mure, themele, struktura të stacioneve të pompimit dhe objekte të impiantit. Preventivi përmban mijëra metra kub beton C16/20, C20/25, C25/30 dhe C30/37.

Karpentier – 5 (pesë)

Kërkohen për realizimin e kallëpeve të trarëve, mureve dhe soletave të betonarmesë. Preventivi përmban mijëra metra katrorë kallëpe për elementë të ndryshëm strukturorë. Kërkohen për zërat: Kallëpe për themele; Kallëpe për mure betonarmeje; Kallëpe për trarë; Kallëpe për soleta; Kallëpe për rezervuarët e impiantit. Për shkak të volumit të punimeve për realizimin e kontratës janë të nevojshme 5 karpentierë.

Hekurkthyes – 4 (katër)

Kërkohen për përgatitjen, prerjen, lakimin dhe montimin e armaturës së betonit. Preventivi përmban mbi 300 ton hekur betoni periodik me diametra të ndryshëm. Kërkohen për realizimin e zërave të armaturës së betonit: Përpunim armature; Prerje dhe lakim armature; Montim armature për themele; Montim armature për mure dhe rezervuarë.

Elektracist – 3 (tre)

Kërkohen për realizimin e instalimeve elektrike të impiantit, stacioneve të pompimit, paneleve elektrike dhe sistemeve të kontrollit. Numri justifikohet nga nevoja për zhvillimin paralel të punimeve elektrike në disa zona të objektit. Kërkohen për: Instalime elektrike; Kabllime; Montim panelesh; Lidhje elektrike të pompave; Ndriçim teknik; Furnizim me energji të impiantit dhe stacioneve të pompimit.

Specialist Konstruksione Metalike – 3 (tre)

Kërkohen për realizimin dhe montimin e elementëve metalikë dhe inox të përfshirë në preventiv, si trarët e vincave, platformat inox, parmakët, shkallët metalike, zgarrat inox dhe porta metalike e impiantit. Kërkohen për realizimin e zërave: Trarë çeliku për vinça; Platforma metalike inox; Shkallë metalike inox; Parmakë inox; Zgara inox; Porta metalike e impiantit. Këta elementë kërkojnë fabrikim dhe montim profesional të konstruksioneve metalike.

Saldator – 4 (katër)

Numri i kërkuar lidhet me volumin e konsiderueshëm të punimeve metalike dhe inox. Saldatorët janë të domosdoshëm për fabrikimin dhe montimin e trarëve të çelikut, platformave inox SST 316, parmakeve inox, shkallëve inox, zgarrave metalike dhe elementëve mbështetës të impiantit. Kërkohen për realizimin e: Saldimit të trarëve metalikë; Saldimit të platformave inox SST 316; Saldimit të shkallëve inox; Saldimit të parmakëve inox; Saldimit të mbajtëseve metalike; Saldimit të elementëve të stacioneve të pompimit. Volumi i punimeve metalike dhe inox të parashikuara në preventiv e ka të domosdoshme kërkesën për 4 saldatorë.

Këta zëra përbëjnë punime speciale metalike që kërkojnë procese saldimi me cilësi të lartë, pasi janë pjesë e strukturave mbajtëse, platformave të mirëmbajtjes dhe sistemeve teknologjike të impiantit.

Veçanërisht, përdorimi i materialeve inox SST 316 në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura kërkon saldatorë të kualifikuar, pasi këto materiale punojnë në kushte agresive korrozioni dhe çdo defekt në saldim mund të shkaktojë: humbje të rezistencës mekanike të elementit; korrozion të përshpejtuar në zonën e saldimit; deformime të konstruksioneve metalike; probleme funksionale të platformave dhe pajisjeve; rritje të kostove të mirëmbajtjes dhe riparimeve.

Për më tepër, në preventiv janë parashikuar punime të shumta të montimit të elementëve metalikë dhe inox në lartësi dhe në ambiente teknologjike të impiantit, ku cilësia e saldimit lidhet drejtpërdrejt me sigurinë strukturore dhe operacionale të objektit.

Bazuar në natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, stacioneve të pompimit dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), Autoriteti Kontraktor gjykon të nevojshme që specialistët saldatorë të disponojnë certifikime profesionale që garantojnë cilësinë, sigurinë dhe jetëgjatësinë e elementëve të salduar që do të instalohen në kuadër të kontratës.

Në preventiv janë parashikuar një sërë zërash që përfshijnë furnizimin dhe instalimin e tubacioneve HDPE SN8 me diametra të ndryshëm, rakorderive, pusetave HDPE, sistemeve të pompimit, tubacioneve prej çeliku inox, elementëve metalikë mbajtës, parmacheve inox, shkallëve metalike, platformave metalike dhe pajisjeve të tjera elektromekanike, për realizimin e të cilave kërkohen procese saldimi me standarde të larta teknike.

Për këtë arsye, kërkohet që 2 (dy) saldatorë të disponojnë certifikim sipas standardit SSH EN ISO 9606-1:2017 për saldimin e çelikut. Ky standard përcakton kërkesat për kualifikimin e saldatorëve për saldimin me shkrirje të materialeve prej çeliku dhe vlerëson aftësinë praktike të saldatorit për të realizuar bashkime me cilësi të pranueshme sipas procedurave të njohura ndërkombëtarisht. Standardi siguron që personeli zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për realizimin e saldimeve strukturore dhe industriale në elementë metalikë dhe pajisje mekanike.

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë tubacione inox me fllanxha, brryla inox, valvula, mbështetëse metalike për pompat, shkallë inox, parmakë inox, platforma metalike dhe konstruksione çeliku të impiantit dhe stacioneve të pompimit, ku cilësia e saldimeve ndikon drejtpërdrejt në sigurinë strukturore dhe funksionimin e sistemit.

Njëkohësisht, kërkohet që 2 (dy) saldatorë të disponojnë certifikim sipas standardit SSH EN ISO 13067:2020 për saldimin e tubave plastikë me proces elektrofuzioni. Ky standard përcakton metodat e testimit të njohurive dhe aftësive të saldatorëve që realizojnë bashkime në sisteme termoplastike, duke përfshirë në mënyrë të veçantë saldimin e tubave dhe rakorderive plastike me proces elektrofuzioni dhe procese të tjera të përdorura në ndërtimin dhe riparimin e rrjeteve të tubacioneve. Standardi konsideron testimin e aftësive të saldatorit si një kusht thelbësor për garantimin e cilësisë së punimeve të saldimit.

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë furnizimin dhe vendosjen e tubave të brinjëzuar HDPE SN8 me diametra të ndryshëm, lidhjet e objekteve me rrjetin publik të kanalizimeve, rakorderitë dhe elementët ndërlidhës të sistemit KUZ. Duke qenë se rrjeti i kanalizimeve funksionon nën kushte hidraulike dhe mjedisore të veçanta, cilësia e bashkimeve me elektrofuzion është kritike për të shmangur rrjedhjet, infiltrimin e ujërave nëntokësore dhe defektet e sistemit gjatë operimit.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave të trajnimit synon të provojë jo vetëm zotërimin formal të certifikimit, por edhe përgatitjen profesionale të personelit që do të angazhohet në realizimin e kontratës. Duke marrë në konsideratë vlerën e investimit, kompleksitetin teknik të objektit dhe rëndësinë e funksionimit të sigurt të rrjetit KUZ dhe ITUN, disponimi i këtyre certifikimeve përbën një garanci të nevojshme për cilësinë e zbatimit të punimeve dhe është në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Specialist Punime Asfalti – 3 (tre)

Kërkohen për realizimin e shtresave rrugore dhe asfaltimeve pas vendosjes së rrjeteve. Preventivi përfshin shtresa stabilizanti, çakëlli, binderi dhe asfaltobetoni në sipërfaqe të konsiderueshme. Kërkohen për zërat: Shtresë stabilizanti; Shtresë çakëlli; Binder; Asfaltobeton; të cilat realizohen pas vendosjes së rrjetit KUZ dhe rikthimit të rrugëve në gjendjen fillestare.

Hidroizolues – 2 (dy)

Kërkohen për realizimin e hidroizolimeve të strukturave të impiantit, rezervuarëve, mureve dhe elementëve të tjerë që janë në kontakt të vazhdueshëm me ujërat e ndotura. Preventivi përmban zëra specifikë për hidroizolim me emulsion bitumi dhe materiale hidroizoluese.

Specialist Montim Tubash – 2 (dy)

Kërkohen për montimin e tubacioneve, rakorderive, nyjeve dhe elementëve të rrjeteve të kanalizimit dhe sistemeve hidraulike të impiantit. Duke qenë se objekti ka si funksion kryesor grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ky profil është i domosdoshëm për realizimin korrekt të rrjetit dhe pajisjeve të lidhura me të. Kërkohen për realizimin e: Montimit të tubacioneve HDPE; Tubacioneve të presionit; Tubacioneve inox; Rakorderive; Fllanxhave; Bërrylave; Tee-ve dhe elementëve lidhës. Ky profil lidhet drejtpërdrejt me zërat kryesorë të rrjetit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura.

Objekti përfshin punime masive gjurmimi, transporti, ndërtimi të rrjetit KUZ, ndërtimi të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, punime rrugore, betonime, montime tubacionesh dhe instalime teknologjike, të cilat kërkojnë përdorimin e vazhdueshëm të makinerive të rënda dhe operatorëve përkatës.

Eskavatoristë – 7 (shtatë)

Kërkesa për 7 eskavatoristë lidhet drejtpërdrejt me numrin e mjeteve të kërkuara në tender: 4 Ekskavatorë me goma 0.25 m³; 3 Ekskavatorë me zinxhir 0.5 m³; 3 Ekskavatorë me çekiç hidraulik; 3 Minieskavatorë.

Në total janë kërkuar 13 mjete gjurmimi, të cilat do të përdoren për: Hapjen e traseve të rrjetit KUZ; Gjurmimet për pusetat dhe stacionet e pompimit; Gjurmimet për rezervuarët dhe strukturat e impiantit; Gjurmimet në shkëmb me çekiç hidraulik; Sistemimin e terrenit dhe mbushjet.

Duke qenë se këto makineri do të operojnë në disa segmente pune njëkohësisht dhe jo të gjitha në të njëjtën kohë, kërkesa për minimumi 7 eskavatoristë konsiderohet proporcionale dhe e nevojshme për garantimin e ritmit të punimeve sipas grafikut të zbatimit.

Automakinistë – 5 (pesë)

Kërkesa për 5 automakinistë justifikohet nga operimi i mjeteve teknologjike të kantierit, konkretisht: 2 Fadroma me goma me kovë para-prapa; 2 Minifadroma; 1 Grejder; 2 Rulë me vibrim; 1 Rul asfalti hekur-hekur; 1 Asfaltoshtruese; 1 Autobitumatriçe; 1 Frezë asfalti.

Këto mjete përdoren për: Sistemimin e terrenit; Mbushjen dhe ngjeshjen e kanaleve; Formimin e shtresave rrugore; Rikonstruksionin e rrugëve pas vendosjes së tubacioneve; Punimet e asfaltimit dhe rikthimit të infrastrukturës rrugore.

Për shkak të volumeve të konsiderueshme të shtresave rrugore dhe asfaltimeve të parashikuara në preventiv, kërkesa për 5 automakinistë është e lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e këtyre punimeve.

Buldozeristë – 3 (tre)

Edhe pse lista e mjeteve nuk përfshin buldozer të dedikuar, operatorët e kategorisë buldozerist përdoren për drejtimin e mjeteve të rënda të sistemimit të terrenit dhe lëvizjes së materialeve, si: Fadromat; Minifadromat; Dumperët me kapacitet mbi 25 ton; Mjetet e sistemimit dhe nivelimit.

Këta operatorë janë të domosdoshëm për: Shpërndarjen e materialeve të mbushjes; Formimin e platformave të impiantit; Sistemimin e zonave të punës; Modelimin e terrenit; Menaxhimin e depozitimit të materialeve të gjurmues.

Volumet shumë të mëdha të gërmimeve dhe mbushjeve justifikojnë disponimin e 3 operatorëve të tillë.

Shoferë – 5 (pesë)

Kërkesa për 5 shoferë lidhet drejtpërdrejt me flotën e automjeteve të transportit të kërkuara në tender: 3 Kamionë vetëshkarkues mbi 20 ton; 3 Kamionë vetëshkarkues 5–10 ton; 4 Kamioncina 3.5–5 ton; 3 Kamionë me vinc; 3 Autobotë uji; 1 Autobot për pastrimin e kanaleve; 1 Rimorkiator për transportin e mjeteve të rënda; 1 Autovinc mbi 40 ton.

Këto mjete përdoren për: Transportin e materialeve të gërmuara; Transportin e aggregateve për mbushje; Transportin e materialeve të ndërtimit; Transportin e tubacioneve HDPE dhe elementëve të kanalizimeve; Transportin e pajisjeve mekanike dhe elektrike të impiantit; Furnizimin me ujë të kantierit; Transportin dhe lëvizjen e makinerive të rënda.

Duke pasur parasysh se vetëm mjetet e transportit të kërkuara janë mbi 15 njësi, kërkesa për minimumi 5 shoferë përbën një kërkesë minimale dhe proporcionale me nevojat reale të objektit.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- **1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimit si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”** të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkepunimit.
 - 1(nje) person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për **“Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise”** e dhëne nga nje organizem i akredituar/licensuar shqiptar ose i huaj. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit, kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën dy muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
 - **1 (nje) inxhinier** duhet te jete i pajisur me Certifikaten per Vleresimin ne Mjedis.
- h) **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- i) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Agumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si **përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash** dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, si dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, kërkesa për disponimin e personit përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe të personit përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe volumnin e punimeve objekt kontrate.

Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë

Objekti i prokurimit përfshin ndërtimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), stacioneve të pompimit dhe sistemit të kanalizimeve, ku do të realizohen njëkohësisht punime civile, hidroteknike, rrugore, mekanike, elektrike dhe metalike.

Preventivi përfshin ndër të tjera: Gërmime masive në tokë dhe shkëmb; Punime në kanale dhe struktura nëntokësore; Punime me ekskavatorë, fadroma, kamionë dhe mjete të tjera të rënda; Punime betonarmeje dhe kallëpesh; Punime me autovinç dhe mjete ngritëse; Punime elektrike dhe elektromekanike; Montim të strukturave metalike dhe inox; Punime saldimi; Punime në lartësi për montimin e platformave, shkallëve dhe parmakëve metalikë; Punime asfaltimi dhe rikonstrukcioni rrugor.

Këto aktivitete klasifikohen si punime me risk të lartë për sigurinë dhe shëndetin në punë, për shkak të përdorimit të makinerive të rënda, punimeve në gërmime të thella, ngritjes së ngarkesave, punimeve elektrike, punimeve në lartësi dhe proceseve të saldimit.

Për rrjedhojë, prania e një personi të trajnuar dhe të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë është e domosdoshme për: Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në kantier; Hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese; Kontrollin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse individuale; Mbikëqyrjen e sigurisë gjatë përdorimit të makinerive dhe pajisjeve; Parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në punë; Zbatimin e Planit të Sigurisë dhe Shëndetit në kantier.

Kjo kërkesë mbështetet drejtpërdrejt në Ligjin nr.10327/2010 dhe VKM nr.312/2010, të cilat ngarkojnë punëdhënësin me detyrimin për organizimin e strukturave të sigurisë dhe mbrojtjes së punëmarrësve në kantieret e ndërtimit.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të disponojë një person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë lidhet me faktin se secili operator mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për punimet që merr përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe për sigurinë e punonjësve të tij gjatë realizimit të këtyre punimeve.

Personi përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë

Kërkesa për disponimin e një personi të trajnuar si “Përgjegjës për Sigurimin dhe Kontrollin e Cilësisë” lidhet drejtpërdrejt me natyrën teknike dhe vlerën e konsiderueshme të kontratës, si dhe me domosdoshmërinë për garantimin e cilësisë së punimeve gjatë gjithë fazës së zbatimit.

Preventivi përfshin një gamë të gjerë procesesh ndërtimore dhe teknologjike, si: Punime gërmimi dhe mbushjeje; Punime betonarmeje; Përpunim dhe montim armature; Punime asfaltimi; Montim tubacionesh HDPE; Saldime të strukturave metalike dhe inox; Instalime elektrike; Instalime mekanike dhe hidraulike; Testime të rrjeteve dhe pajisjeve; Punime hidroizolimi dhe mbrojtjeje antikorrozive.

Për realizimin e këtyre punimeve është e nevojshme monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i: Cilësisë së materialeve të përdorura; Përputhshmërisë së punimeve me projektin; Zbatimit të specifikimeve teknike; Testimeve dhe provave të materialeve; Dokumentacionit të cilësisë; Procedurave të kontrollit gjatë zbatimit.

Personi përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë garanton që punimet të realizohen sipas standardeve teknike, specifikimeve të projektit, kushteve të kontratës dhe kërkesave ligjore në fuqi, duke minimizuar rrezikun e defekteve, moskonformiteteve dhe punimeve jashtë standardeve.

Për më tepër, objekti përfshin elementë të specializuar si tubacione HDPE me saldim, struktura inox SST 316, sisteme elektromekanike, betonarme dhe rrjete kanalizimi, të cilat kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë gjatë çdo faze të realizimit.

Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e një personi të trajnuar dhe certifikuar për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë është në raport të drejtë me natyrën, kompleksitetin teknik, volumin e punimeve dhe rëndësinë funksionale të objektit, si dhe përbën një garanci të domosdoshme për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara teknike dhe ligjore.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kjo kërkesë duhet të plotësohet nga secili anëtar i BOE-së, pasi secili operator është përgjegjës për cilësinë e punimeve që merr përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe duhet të disponojë kapacitetet e nevojshme për kontrollin e cilësisë së punimeve që do të ekzekutojë.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, kërkesa për disponimin e një inxhinieri të pajisur me Certifikatë për Vlerësimin në Mjedis dhe një Specialisti Ekspert Zjarrfikës është përcaktuar në funksion të natyrës së veçantë të objektit, kompleksitetit teknik të punimeve dhe kërkesave ligjore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë nga zjarri.

Inxhinier i pajisur me Certifikatë për Vlerësimin në Mjedis

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me faktin se objekti i prokurimit është ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), stacioneve të pompimit dhe sistemit të kanalizimeve, të cilat klasifikohen si vepra me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis.

Punimet e parashikuara në preventiv përfshijnë: Gërmime masive në tokë dhe shkëmb; Transport dhe depozitim materialesh; Ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve; Punime hidraulike dhe hidroteknike; Ndërtimin e rezervuarëve dhe strukturave të trajtimit të ujërave; Menaxhimin e ujërave të ndotura; Punime të inxhinierisë mjedisore; Menaxhimin e mbetjeve inerte dhe materialeve të dala nga gërmimet.

Për shkak të natyrës së objektit, gjatë zbatimit të kontratës duhet të monitorohen vazhdimisht: Respektimi i kushteve të vendimit mjedisor; Menaxhimi i mbetjeve të krijuara nga punimet; Mbrojtja e tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; Kontrolli i pluhurave, zhurmave dhe ndotjeve të mundshme; Masat rehabilituese dhe mbrojtëse të mjedisit.

Prania e një inxhinieri të certifikuar në fushën e vlerësimit mjedisor garanton që punimet të realizohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe me kushtet teknike të projektit, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të objektit.

Specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin

Kërkesa për disponimin e një Specialisti Ekspert Zjarrfikës, të certifikuar sipas Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, lidhet me natyrën teknologjike dhe industriale të objektit.

Objekti përfshin: Ndërtime teknologjike të impiantit; Kabina elektrike dhe panele elektrike; Pajisje elektromekanike; Stacione pompimi; Gjeneratorë; Sisteme automatizimi dhe komandimi; Punime saldimi dhe prerjeje metalike; Struktura metalike dhe inox; Depozitim dhe përdorim të lëndëve ndihmëse teknologjike.

Gjatë fazës së ndërtimit ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme që lidhen me: Punimet e saldimit dhe prerjes metalike; Përdorimin e energjisë elektrike; Operimin e gjeneratorëve dhe pajisjeve elektromekanike; Punimet në ambiente të mbyllura dhe struktura teknologjike; Përdorimin e karburanteve dhe lubrifikantëve për makineritë e rënda.

Specialisti Ekspert Zjarrfikës është i nevojshëm për: Vlerësimin e riskut nga zjarri gjatë zbatimit të punimeve; Kontrollin e masave parandaluese kundër zjarrit; Hartimin dhe monitorimin e procedurave të emergjencës; Kontrollin e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri në kantier; Verifikimin e respektimit të kërkesave të mbrojtjes nga zjarri për objektet dhe instalimet teknologjike.

Gjithashtu, duke qenë se objekti përfshin instalime elektrike, mekanike dhe struktura teknologjike që do të jenë në funksion të përhershëm pas përfundimit të punimeve, ekspertiza në fushën e mbrojtjes nga zjarri është e nevojshme për garantimin e sigurisë së veprës dhe të personelit gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit.

Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e një Inxhinieri të pajisur me Certifikatë për Vlerësimin në Mjedis dhe të një Specialisti Ekspert Zjarrfikës është në raport të drejtë me natyrën e objektit, kompleksitetin e punimeve, karakterin mjedisor të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, praninë e instalimeve elektrike dhe elektromekanike, si dhe me nevojën për garantimin e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë nga zjarri gjatë realizimit të kontratës.

Nga vetë natyra e tyre, këto aktivitete paraqesin rrezik të shtuar për aksidente në punë, dëmtime fizike, ekspozim ndaj zhurmave, pluhurave, vibrimeve, materialeve të ndërtimit, proceseve të saldimit dhe pajisjeve elektrike.

Gjithashtu, për realizimin e kontratës është kërkuar një numër i konsiderueshëm punonjësish, personel teknik, specialistë, operatorë makinerish dhe punëtorë ndërtimi, të cilët do të punojnë paralelisht në disa fronte pune. Për rrjedhojë, monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes shëndetësore të punëmarrësve dhe ofrimi i asistencës mjekësore në rast emergjencash përbën një element të domosdoshëm të organizimit të kantierit.

Prania e mjekut të shoqërisë ose e një mjeku të kontraktuar garanton: Mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve; Vlerësimin e aftësisë për punë sipas pozicioneve përkatëse; Menaxhimin e rasteve të aksidenteve në punë dhe emergjencave shëndetësore; Bashkëpunimin me personin përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë; Zbatimin e kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve në kantier.

Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme në një objekt si impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, ku përveç punimeve të zakonshme të ndërtimit, punonjësit mund të ekspozohen ndaj faktorëve biologjikë, mjedisorë dhe teknologjikë që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm shëndetësor.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kërkesa që secili anëtar që përmbush kriteret e VKM nr.742, datë 06.11.2003 të disponojë mjek të shoqërisë ose mjek të kontraktuar, lidhet me faktin se secili operator është punëdhënës i pavarur për personelin që angazhon dhe mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve të tij gjatë realizimit të pjesës së kontratës që ka marrë përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e mjekut të shoqërisë ose mjekut të kontraktuar është në raport të drejtë me natyrën e objektit, nivelin e riskut të punimeve, numrin e konsiderueshëm të punonjësve dhe detyrimet ligjore që lidhen me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, duke përbërë një masë të nevojshme për realizimin e sigurt dhe efektiv të kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me **Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinin, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme”**
Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentim: Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë Licencën e QKB-së kategoria III.2.B është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në ndërtimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), stacioneve të pompimit dhe sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura.

Nga analiza e preventivit rezulton se kontrata përfshin: Punime gjurmimi për hapjen e traseve të tubacioneve; Gjurmime për themele, rezervuarë, puseta dhe objekte teknologjike; Transport të materialeve të dala nga gjurmimet; Prishje dhe rikonstruksion të shtresave rrugore dhe sipërfaqeve ekzistuese; Punime betoni dhe betonarmeje; Punime sistemimi dhe rikthimi të gjendjes ekzistuese.

Disponimi i kësaj licence garanton që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore dhe kapacitetin për: grumbullimin e mbetjeve inerte të gjeneruara gjatë punimeve; transportin e tyre në venddepozitime të autorizuar; respektimin e kërkesave të legjislacionit mjedisor; shmangien e depozitimit të paligjshëm të mbetjeve në territor; mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga punimet.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për disponimin e Licencës Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve të ngurta inerte” është e lidhur drejtpërdrejt me zërat konkretë të preventivit, me volumin e gjurmimeve dhe punimeve civile të parashikuara në kontratë, është proporcionale me objektin e prokurimit dhe e nevojshme për garantimin e zbatimit të investimit në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me Licencë profesionale të kategorisë III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për veprimtarinë “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinin, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme” është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor si një kërkesë e lidhur drejtpërdrejt me natyrën, objektin dhe proceset teknologjike të punimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës.

Kjo kërkesë nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garanton që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën të ketë kapacitetet ligjore, profesionale dhe teknike për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë procesit të ndërtimit, në përputhje me kërkesat mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

Objekti i kontratës përfshin punime ndërtimore dhe infrastrukturore, gjatë realizimit të të cilave krijohen sasi të konsiderueshme materialesh dhe mbetjesh, të cilat kërkojnë menaxhim të kontrolluar.

Gjatë proceseve të punës mund të krijohen: mbetje inerte nga punimet e gjurmimit; materiale të dala nga prishjet dhe çmontimet; mbetje betoni, asfalti, tullash dhe materialesh ndërtimore;

materiale të tepërta nga punimet e rikonstruksionit; ambalazhe dhe materiale ndihmëse të përdorura gjatë zbatimit.

Këto materiale nuk mund të trajtohen si mbetje të zakonshme urbane, por kërkojnë grumbullim, transport, depozitim të përkohshëm dhe menaxhim sipas kërkesave teknike dhe mjedisore.

Disponimi i licencës III.2.B garanton që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore dhe aftësinë profesionale për: mbledhjen e mbetjeve të krijuara gjatë punimeve; transportimin e tyre me mjete të përshtatshme; ruajtjen/magazininin e kontrolluar kur është e nevojshme; dërgimin e tyre për rikuperim ose trajtim sipas destinacionit të lejuar.

Kërkesa për këtë licencë lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë: punime gjurmimi dhe largimi të materialeve të tepërta; prishje të strukturave ekzistuese; pastrim dhe sistemim të zonave të punës; transport të materialeve të dala nga punimet; menaxhim të mbetjeve të krijuara gjatë realizimit të objektit.

Në këto procese, operatori ekonomik nuk kryen vetëm punime ndërtimore, por merr përsipër edhe detyrimin për menaxhimin korrekt të materialeve të dala nga procesi i ndërtimit, duke shmangur depozitimet e pakontrolluara dhe ndikimet negative në mjedis.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kërkesa për kapacitetet profesionale, teknike dhe ligjore të operatorëve ekonomikë, me kusht që këto kërkesa të jenë: të lidhura me objektin e kontratës; proporcionale me natyrën dhe përmasat e saj; të nevojshme për garantimin e realizimit të kontratës.

Në këtë rast, kërkesa për licencën III.2.B është e justifikuar pasi lidhet drejtpërdrejt me një detyrim që lind gjatë zbatimit të kontratës, konkretisht menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga punimet.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht kriteret e veçanta të kualifikimit. Për këtë arsye, kjo kërkesë është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik të ketë një kapacitet të provueshëm dhe të autorizuar për realizimin e detyrimeve mjedisore të kontratës.

Legjislacioni shqiptar për menaxhimin e mbetjeve përcakton detyrimin që mbetjet të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar, duke garantuar: mbrojtjen e mjedisit; parandalimin e ndotjes; transportimin dhe trajtimin nga subjekte të autorizuar; gjurmueshmërinë e procesit të menaxhimit të mbetjeve.

Për këtë arsye, operatori që realizon punimet duhet të ketë kapacitete të ligjshme për menaxhimin e mbetjeve që krijohen gjatë zbatimit të objektit.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për punimet infrastrukturore, ku volumi i materialeve të dala nga gjurmimet, prishjet dhe punimet ndërtimore mund të jetë i konsiderueshëm.

Kërkesa për Licencë III.2.B është proporcionale pasi lidhet me një proces real që do të ndodhë gjatë zbatimit të punimeve; siguron respektimin e detyrimeve mjedisore; garanton që operatori ekonomik ka njohuritë dhe autorizimet për menaxhimin e mbetjeve.

Në mungesë të kësaj licence ekziston risku që: mbetjet të transportohen ose depozitohen në mënyrë jo të ligjshme; të krijohen probleme mjedisore; Autoriteti Kontraktor të përballlet me përgjegjësi administrative apo mjedisore; të cenohet cilësia dhe qëndrueshmëria e realizimit të objektit.

Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e mundshme të materialeve të dala nga procesi i ndërtimit, detyrimet për mbrojtjen e mjedisit dhe kërkesat ligjore për menaxhimin e mbetjeve, kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë Licencë III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme” është një kriter teknik dhe profesional i domosdoshëm.

2.3.4. Makineri Pajisje

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr.	Pershkrimi	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	3 copë
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 5-10 Ton	3 copë
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	4 copë
4	Kamion me vinc	3 copë
5	Autovinc mbi 40 ton	1 cope
6	Ekskavator me goma 0.25 m ³ MT (mjet teknologjik me targa)	4 copë
7	Ekskavator me zinxhir 0.5 m ³	3 copë
8	Eskavator me cekic	3 copë
9	Minieskavator	3 copë
10	Fadrom me goma me kove para mbrapa MT (mjet teknologjik me targa)	2 copë
11	Minifadrom MT (mjet teknologjik me targa)	2 copë
12	Grejder MT (mjet teknologjik me targa)	1 copë
13	Rul (kompresor) me vibrim	2 copë
14	Rrul Asfalti hekur-hekur	1 copë
15	Dumper me kapacitet mbajtes mbi 25 ton	3 copë
16	Autobetoniere	4 copë
17	Autobetonierë kantieri 2-4 m ³ MT (mjet teknologjik me targa)	3 copë
18	Autopompe betoni	2 copë
19	Asfaltoshtruese	1 copë
20	Autobitumatriçe	1 copë
21	Freze Asfalti	1 copë
22	Autobot uji	3 copë
23	Autobot për pastrim kanalesh (ujra të zeza)	1 copë
24	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda min 20 ton + koke tërheqese	1 copë
25	Tokmak elektrik	3 copë
26	Vibrator betoni	2 copë
27	Matrapik	2 copë
28	Elektrosaldatriçe	2 copë
29	Elektro argano	1 copë
30	Betoforma (armaturë, kallëp) tërëse	1000 m ²
31	Vinç kulle 0.5 – 1 ton	1 copë
32	GPS/Total Station	2 copë
33	Gjeneratore	1 copë

34	<i>Pajisje per hekurkthyes (tranxhe, elektrobango)</i>	<i>3 copë</i>
35	<i>Kapese per lidhje hekuri</i>	<i>2 copë</i>
36	<i>Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)</i>	<i>2 cope</i>
37	<i>Makineri per testime me presion uji</i>	<i>2 copë</i>
38	<i>Makineri saldimi HDPE me bashkim (DN 150–500 mm)</i>	<i>4 copë</i>
39	<i>Automjet teknologjik per inspektimin e kolektorëve e pajisur me dy ose me shume sisteme kamerash per gjatesi inspektimi jo me pak se 200 m</i>	<i>1 copë</i>
40	<i>Aparat elektrofuziv</i>	<i>4 copë</i>
41	<i>Rulorë/mbështetës portativë për shtrirjen e tubave</i>	<i>4 copë</i>
42	<i>Kapëse hidraulike tubash</i>	<i>4 copë</i>
43	<i>Prerës tubash portativë</i>	<i>4 copë</i>

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 70 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë
- Uniforma/Jelek pune 100 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te saktësisese informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do te konsiderohet kusht për skualifikim.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjsuara me origjinalin, si më poshtë:

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesine e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatëse e qerasë, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të

dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore **e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Bazuar në objektin e prokurimit "Impianti i Trajtimin të Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ, Dhërmi", si dhe në volumet e konsiderueshme të punimeve të parashikuara në preventiv, kërkesa për disponimin e mjeteve dhe makinerive të mëposhtme është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës.

Nga preventivi rezultojnë volume të konsiderueshme punimesh, ndër të cilat: Germime dheu dhe shkëmbi mbi 200,000 m³. Transport materialesh, dherash dhe shkëmbi mbi 150,000 m³. Vendosije tubacionesh HDPE SN8 Ø200–600 mm mbi 20 km rrjet kanalizimesh. Realizimi i 890 lidhjeve familjare me rrjetin KUZ. Ndërtimi i mbi 1,100 pusetave HDPE. Ndërtimi i 2 stacioneve të pompimit. Ndërtimi i ITUN me volume të mëdha betoni, armature, punime mekanike dhe elektromekanike. Punime asfaltimi dhe rikonstruksioni rrugësh pas vendosjes së rrjetit.

Për këtë arsye, mjetet dhe makineritë argumentohen si më poshtë:

1. Kamionë vetëshkarkues mbi 20 ton (3 copë)

Kërkohen për transportin e sasive të mëdha të materialeve të gërmimit, shkëmbit, zhavorrit, rërës, çakëllit dhe materialeve të ndërtimit. Preventivi parashikon transport të konsiderueshëm të dherave dhe shkëmbit nga gërmimet masive të rrjetit KUZ dhe ITUN.

2. Kamionë vetëshkarkues 5–10 ton (3 copë)

Nevojiten për transport në zona urbane me akses të kufizuar dhe për shpërndarjen e materialeve përgjatë segmenteve të rrjetit të kanalizimeve.

Kamionë vetëshkarkues mbi 20 ton (3 copë), Kamionë vetëshkarkues 5-10 ton (3 copë), Dumper mbi 25 ton (3 copë)

Këto mjete janë të domosdoshme për realizimin e zërave: Zëri Nr.1 “Gërmim dheu me ekskavator” – 2,108 m³. Zëri Nr.2 “Gërmim shkëmbi i copëtuar me ekskavator” – 8,932 m³. Zëri Nr.4 “Transport dheu me auto deri 3 km” – 90,972 m³. Zëri Nr.5 “Gërmim shkëmbi i fortë me çekiç” – 9,890 m³. Zëri Nr.6 “Gërmim shkëmbi me shkarkim në mjet” – 46,885 m³. Zëri Nr.7 “Gërmim dheu me shkarkim në mjet” – 16,590 m³. Zëri Nr.8 “Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç” – 17,085 m³. Zëri Nr.9 “Transport materiale ndërtimi dheu me auto” – 1,130 m³.

Volumi i përgjithshëm i gërmimeve dhe transportit tejkalon 190,000 m³, çka justifikon numrin e kërkuar të mjeteve të transportit.

3. Kamioncina 3.5–5 ton (4 copë)

Përdoren për transportin e materialeve ndihmëse, pajisjeve elektromekanike, veglave dhe ekipeve të punës në disa fronte pune njëkohësisht.

4. Kamion me vinç (3 copë)

Nevojitet për ngarkim-shkarkimin e tubave HDPE me diametra të mëdhenj, pusetave prefabrikate, pajisjeve mekanike dhe materialeve të rënda.

5. Autovinç mbi 40 ton (1 copë)

Kërkohet për montimin e pajisjeve të rënda të stacioneve të pompimit dhe ITUN, si pompa, rezervuarë, elementë metalikë dhe pajisje elektromekanike.

6–9. Ekskavatorë me goma, ekskavatorë me zinxhir, ekskavatorë me çekiç dhe miniekskavatorë

Këto mjete lidhen drejtpërdrejt me zërat e gërmimeve të dheut dhe shkëmbit për vendosjen e rrjetit KUZ, ndërtimin e stacioneve të pompimit dhe ITUN. Në preventiv janë parashikuar gërmime të konsiderueshme në tokë dhe shkëmb, përfshirë përdorimin e çekiçit hidraulik.

Ekskavatorë me goma, ekskavatorë me zinxhir, ekskavatorë me çekiç dhe miniekskavatorë

Lidhen drejtpërdrejt me zërat: Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.5, Nr.6, Nr.7, Nr.8 dhe Nr.10 të preventivit që përfshijnë gërmime në dhe, shkëmb dhe seksione të detyruara.

Për shkak të shtrirjes së rrjetit KUZ në disa fronte pune dhe pranisë së gërmimeve në terrene të ndryshme, kërkohet disponimi i disa mjeteve të këtij lloji.

10–11. Fadromë dhe minifadromë

Nevojiten për ngarkimin e materialeve, sistemimin e sheshit të punimeve, mbushjet dhe transportet e brendshme në kantier.

Lidhen me zërat: Zëri Nr.11 “Mbushje me shkëmb të gërmuar më parë” – 10,540 m³. Zëri Nr.12 “Mbushje me zhavorr pas mureve” – 80 m³. Zëri Nr.21 “Shtresë çakëlli” – 2,975 m². Zëri Nr.22 “Shtresë çakëlli” – 630 m². Zëri Nr.23 “Shtresë stabilizanti” – 804.33 m².

12. Grejder

Përdoret për profilimin e shtresave rrugore dhe rikthimin e gjendjes së rrugëve pas vendosjes së kanalizimeve.

13–14. Rul vibrues dhe rul asfalti

Lidhen me zërat e shtresave rrugore dhe asfaltimeve që parashikohen pas përfundimit të punimeve të kanalizimeve.

Grejder, Rul vibrues, Rul asfalti hekur-hekur

Lidhen me: Zëri Nr.19 “Shtresë asfaltobetoni” – 2,975 m³. Zëri Nr.20 “Shtresë binderi” – 2,975 m³. Zëri Nr.21, 22 dhe 23 për shtresat rrugore dhe stabilizimin.

Këto mjete janë të nevojshme për rikthimin e gjendjes së rrugëve pas vendosjes së rrjetit të kanalizimeve

15. Dumper mbi 25 ton

Nevojitet për transportin e sasive të mëdha të materialeve në zonën e ITUN dhe në gërmimet masive.

16–18. Autobetonierë, autobetonierë kantieri dhe autopompa betoni

Në ITUN janë parashikuar mijëra m³ struktura betoni dhe betonarmeje. Për realizimin e këtyre volumeve kërkohet furnizim dhe hedhje e vazhdueshme e betonit.

Lidhen me: Zëri Nr.13 “Struktura monolite betoni C25/30” – 2,353.4 m³. Zëri Nr.14 “Struktura monolite betoni C20/25” – 14.25 m³. Zëri Nr.15 “Struktura monolite betoni C30/37” – 1,572.38 m³. Zëri Nr.24 “Beton C16/20” – 390 m³.

Volumi total i betonit tejkalon 4,300 m³ dhe kërkon furnizim e hedhje të vazhdueshme në strukturat e ITUN dhe stacioneve të pompimit.

19–21. Asfaltoshtruese, autobitumatriçe dhe frezë asfalti

Lidhen drejtpërdrejt me zërat e prerjes së asfaltit, skarifikimit dhe rivendosjes së shtresave asfaltike përgjatë rrjetit KUZ.

Këto mjete kërkohen për realizimin e punimeve të rikonstruksionit dhe rivendosjes së shtresave rrugore që preken nga ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe lidhjeve të objekteve me rrjetin KUZ.

Konkretisht, ato lidhen me zërat e preventivit: Zëri 2.37/2b “Transport materiale ndërtimi dheu me auto”, i cili lidhet me punimet e hapjes dhe mbylljes së trasesë së kanalizimeve. Zërat e mbushjeve dhe shtresave rrugore që realizohen pas vendosjes së tubacioneve HDPE dhe pusetave të kanalizimeve. Zëri An.185 “Ndërtimi i shtresës me pllaka betoni me trashësi 5 cm në trotualet dhe shëtitoret anësore të ndërtesës”, si pjesë e rikthimit të sipërfaqeve të prekura nga punimet. Të gjithë zërat e rrjetit KUZ ku parashikohet vendosja e tubacioneve HDPE, pusetave dhe lidhjeve të abonentëve, të cilat kërkojnë ndërhyrje në trupin e rrugës dhe më pas rikthimin e saj në gjendjen fillestare.

***Freza e asfaltit** nevojitet për prerjen dhe frezimin e shtresave ekzistuese asfaltike përgjatë trasesë së kanalizimeve, me qëllim krijimin e një prerjeje të rregullt dhe përgatitjen e sipërfaqes për riveshje. Kjo makineri përdoret zakonisht në punimet e rehabilitimit dhe rikonstruksionit të shtresave asfaltike.*

***Autobitumatricja** nevojitet për spërkatjen e emulsioneve bituminoze (coat/tack coat) dhe krijimin e lidhjes teknologjike ndërmjet shtresave ekzistuese dhe shtresave të reja asfaltike gjatë rikthimit të rrugëve të prekura nga punimet e kanalizimeve.*

***Asfaltoshtuesja** nevojitet për shtrimin uniform të shtresave asfaltike dhe binderit në segmentet rrugore ku do të kryhen punime për vendosjen e rrjetit KUZ, duke garantuar parametrat teknikë të kërkuar për përfundimin e shtresave rrugore sipas projektit.*

Për rrjedhojë, disponimi i këtyre mjeteve është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të rikthimit të infrastrukturës rrugore të prekur nga ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe garantimin e cilësisë së shtresave asfaltike sipas kërkesave të projektit.

22. Autobot uji

Nevojitet për lagien e shtresave gjatë ngjeshjes, kontrollin e pluhurave dhe provat hidraulike.

Kërkesa për disponimin e 3 (tre) autobotëve të ujit është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe volumet e punimeve të parashikuara në preventiv për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, stacioneve të pompimit dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN).

Autoboti i ujit përdoret për lagien e shtresave të dheut dhe materialeve granulare gjatë procesit të ngjeshjes, kontrollin e pluhurave gjatë gërmimeve dhe transportit të materialeve, si dhe për kryerjen e provave hidraulike dhe pastrimin e zonave të punës. Disponimi i këtij mjeti është i domosdoshëm për garantimin e parametrave teknikë të shtresave mbushëse dhe për respektimin e kërkesave të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në kantier.

*Konkretisht, autoboti i ujit lidhet me zërat e preventivit: **Zëri 3.353 – Mbushje me shkëmb të gërmuar më parë**, me sasi **667.8 m³**, ku materiali duhet të laget para dhe gjatë procesit të ngjeshjes për të arritur densitetin e kërkuar teknik. **Zëri 2.37/2b – Transport materiale ndërtimi, dheu me auto**, me sasi **546 m³**, si dhe me të gjitha punimet e gërmimit dhe transportit të materialeve, ku krijohen nivele të konsiderueshme pluhuri dhe kërkohet lagia periodike e trasesë së punimeve. Të gjithë zërat që lidhen me ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, vendosjen e tubacioneve HDPE dhe mbylljen e kanaleve të gërmimit, ku materialet mbushëse duhet të lagen dhe ngjeshen sipas specifikimeve teknike të projektit. **Zëri An.190 – Ndërtimi i pusetave për ujërat e shiut**, si dhe zërat e rrjetit KUZ dhe të stacioneve të pompimit, ku nevojitet shpëlarja dhe pastrimi i elementëve të ndërtuar përpara testimeve dhe kolaudimit. **Zëri An.183 – Realizimi i testit të dhomës së llumit të aktivizuar**, ku nevojiten sasi uji për testime funksionale dhe operacionale të strukturave të impiantit.*

Gjithashtu, duke qenë se objekti përfshin një rrjet të gjerë kanalizimesh dhe disa fronte pune që zhvillohen paralelisht, disponimi i 3 (tre) autobotëve të ujit siguron furnizimin e vazhdueshëm me ujë për lagien e shtresave, kontrollin e pluhurave, pastrimin e kantierit dhe realizimin e testimeve teknike, pa penguar ritmin e punimeve dhe afatet e zbatimit të kontratës.

23. Autobot për pastrim kanalesh (ujëra të zeza)

Objekti ka të bëjë me sistemin e kanalizimeve dhe stacionet e pompimit. Ky mjet është i nevojshëm për pastrimin e kolektorëve ekzistues, zbrazjen e pusetave dhe ndërhyrjet në rrjet gjatë zbatimit.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) autoboti për pastrimin e kanaleve dhe kolektorëve të ujërave të zeza është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në ndërtimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUZ), stacioneve të pompimit dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN).

Ky mjet është i pajisur me sistem presioni të lartë dhe sistem vakumi për thithjen, pastrimin dhe largimin e depozitimeve, llumrave, mbetjeve dhe ujërave të ndotura nga kolektorët, pusetat dhe strukturat hidraulike. Disponimi i tij është i nevojshëm për realizimin e operacioneve të pastrimit, shpëlarjes dhe testimit të rrjetit përpara vënies në funksion dhe marrjes në dorëzim të veprës.

*Konkretisht, ky mjet lidhet me zërat e preventivit që kanë të bëjnë me: Ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve me tuba HDPE SN8 me diametra të ndryshëm, ku pas përfundimit të instalimit kërkohet pastrimi dhe shpëlarja e tubacioneve përpara kryerjes së provave teknike dhe kolaudit. Ndërtimin e pusetave të kanalizimeve dhe lidhjeve të abonentëve me rrjetin publik, ku gjatë punimeve mund të krijohen depozitime inertesh, llumrash dhe mbetjesh që duhet të largohen përpara vënies në funksion të sistemit. Ndërtimin dhe vënien në punë të stacioneve të pompimit të ujërave të zeza, ku kërkohet pastrimi i dhomave teknologjike, tubacioneve të thithjes dhe shkarkimit, si dhe eliminimi i mbetjeve që mund të krijohen gjatë procesit të ndërtimit. **Zërin An.183 – Realizimi i testit të dhomës së llumit të aktivizuar**, me sasi 4,875 m³, i cili lidhet drejtpërdrejt me proceset e trajtimit të llumit dhe ujërave të ndotura dhe kërkon pastrim e menaxhim të strukturave përpara dhe gjatë testimeve funksionale. **Zërin An.180 – Punime speciale të stacionit të pompimit**, ku funksionimi korrekt i pajisjeve dhe tubacioneve kërkon pastrim dhe shpëlarje të strukturave hidraulike para komisionimit të sistemit.*

Përveç fazës së zbatimit, ky mjet është i nevojshëm edhe për ndërhyrjet emergjente gjatë punimeve në rast infiltrimesh, bllokimesh ose grumbullimi të ujërave të ndotura në kolektorë dhe puse, duke garantuar vijimësinë e punimeve dhe sigurinë e personelit në kantier.

24. Rimorkiator për transport mjeteve të rënda

Kërkohet për transportin e ekskavatorëve, rulave, grejderëve dhe mjeteve të tjera të rënda midis fronteve të punës.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) rimorkiatori për transportin e mjeteve të rënda me kapacitet minimal 20 ton, së bashku me kokën tërheqëse, lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe volumet e punimeve të objektit, i cili përfshin ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, stacioneve të pompimit dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN).

Për realizimin e punimeve janë kërkuar mjete të rënda si ekskavatorë me zinxhir, ekskavatorë me goma, ekskavatorë me çekiç, rul vibrues, grejder, fadroma, asfaltoshtruese, autobitumatriçe dhe makineri të tjera teknologjike, të cilat për shkak të përmasave, peshës dhe karakteristikave teknike nuk mund të qarkullojnë në mënyrë të vazhdueshme në rrugët publike ose nuk mund të zhvendosen në distanca të konsiderueshme pa mjete të specializuara transporti.

Disponimi i rimorkiatorit lidhet me: Punimet e gërmimeve masive në dhe dhe shkëmb, për realizimin e të cilave përdoren ekskavatorë me zinxhir, ekskavatorë me çekiç dhe mjete të tjera të rënda. Punimet e mbushjeve, sistemimeve dhe ngjeshjeve, ku angazhohen fadroma, grejderë dhe

rulë. Punimet e rikonstruksionit të shtresave rrugore, ku përdoren asfaltoshtruese, autobitumatriçe dhe freza asfalti. Punimet në stacionet e pompimit dhe në zonën e ITUN, ku mjetet e rënda duhet të zhvendosen sipas fazave të zbatimit të projektit.

Duke qenë se objekti përfshin punime të shpërndara në segmente të ndryshme të rrjetit të kanalizimeve dhe në disa zona pune njëkohësisht, lind nevoja për transportimin e shpejtë dhe të sigurt të mjeteve teknologjike nga një front pune në tjetrin, pa ndërprerë ritmin e punimeve dhe pa krijuar vonesa në afatet kontraktore.

Gjithashtu, transporti i mjeteve të rënda me rimorkiator garanton respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor, shmang konsumimin e panevojshëm të makinerive dhe redukton rrezikun e dëmtimeve gjatë lëvizjes së tyre në rrugë publike.

Për rrjedhojë, disponimi i një rimorkiatori për transportin e mjeteve të rënda me kapacitet minimal 20 ton është i nevojshëm dhe proporcional me natyrën e kontratës, duke garantuar mobilizimin e makinerive të kërkuara për realizimin e punimeve sipas programit të zbatimit dhe specifikimeve teknike të projektit.

25–29. Tokmak elektrik, vibrator betoni, matrapik, elektrosaldatriçe dhe elektroorgano

Janë pajisje të domosdoshme për punimet e betonit, montimet mekanike dhe punimet e saldimin të elementëve metalikë të ITUN dhe stacioneve të pompimit.

Kërkesa për disponimin e këtyre pajisjeve është përcaktuar në funksion të natyrës së punimeve civile, strukturore, mekanike dhe elektromekanike që parashikohen në objektin e prokurimit, si dhe të volumeve të konsiderueshme të punimeve të betonit, betonarmesë, montimeve metalike dhe instalimeve teknologjike të rrjetit KUZ, stacioneve të pompimit dhe Impiantit të Trajtimin të Ujërave të Ndotura (ITUN).

1. Tokmak elektrik (3 copë)

Tokmaku elektrik është i domosdoshëm për ngjeshjen e shtresave të mbushjes në hapësira të kufizuara, veçanërisht në kanalet e tubacioneve, rreth pusëve dhe pranë strukturave të betonit ku nuk mund të operojnë makineri të rënda ngjeshëse.

